



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12, datë 30.09.2022

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në pallatin e kulturës  
“Labëria “ ( Ora 10<sup>15</sup>)

Marrin pjesë:

- |                      |                      |
|----------------------|----------------------|
| 1.Brunilda Cani      | 17.Sulltana Bilbilaj |
| 2.Ramona Jaho        | 18.Pëllumb Nezha     |
| 3.Asime Feraj        | 19.Elona Toçaj       |
| 4.Ardian Skëndaj     | 20.Anisa Shabanaj    |
| 5.Brunilda Saliaj    | 21.Kasëm Mahmuti     |
| 6.Bujar Osmanaj      | 22.Sokol Kushta      |
| 7.Grigor Dede        | 23.Kristaq Meçi      |
| 8.Jonela Halili      | 24.Andi Resulaj      |
| 9.Jerina Dervishaj   | 25.Teki Xhemalaj     |
| 10. Migena Balla     | 26.Julian Bleta      |
| 11.Englantina Imeraj | 27.Liljana Breshani  |
| 12.Kreshnik Tepelena | 28.Istref Dobi       |
| 13.Rudi Pashaj       | 29.Anxhela Aliraj    |
| 14.Frosina Qyrdeti   | 30.Lindrit Beqiraj   |
| 15.Simo Petromilo    | 31.Briseida Çakërri  |
| 16.Rozina Kormuzi    | 32.Roneda Muçaj      |

Mungojnë :

- 1.Ina Islamaj
- 2.Ervis Moçka

- 3.Ervis Caushaj
- 4.Klearda Rapushi
- 5.Alboren Aliaj
- 6.Klara Bajaziti
- 7.Edlira Kapllanaj
- 8.Sulejmën Bubeqi
- 9.Arben Meksi
- 10.Mujo Shakaj
- 11.Edison Kapaj
- 12.Gentian Hamzaraj
- 13.Adiola Gjoka
- 14.Paula Sullaj
- 15.Evis Allushi
- 16.Fatos Rukaj
- 17.Besian Gega



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/1, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Përshëndetje të gjithëve !

Fillojmë mbledhjen në ditën e sotme me materialet e ardhura në postën elektronike. Por, si fillim, zonja Jonela do të na njohë me shprehjet e ligjshmërisë.

Znj.Jonela Halili – Nga institucioni i prefektit të qarkut për mbledhjen e datës 01.09.2022 , për vendimet e këshillit të bashkisë Nr 65,66,67 dhe 68, janë të ligjshëm. Shprehja e ligjshmërisë për mbledhjen e datës 19.08.2022, për vendimet e këshillit të bashkisë Nr 61,62, dhe 63 janë të ligjshëm .Vetëm vendimi Nr 64 , është jo i ligjshëm, ku bashkëlidhur ka relacion spjegues.

(Lexon relacionin, në lidhje me vendimin nr 64, jo i ligjshëm, parregullsitë e konstatuara ) si;

-Nuk është respektuar procedura e kërkuar nga ligji.

-Nuk është shoqëruar nga ndonjë relacion sqarues.

-Nuk është zbatuar neni 8, i ligjit Nr 139/2015 si dhe neni 6 i ligjit Nr 146/2014 , për njoftimin dhe konsultimin publik etj, ....Vendimi nr 64 , është i paligjshëm dhe duhet të kthehet për rishqyrtim.

Z.Ardian Skëndaj - Sa herë e ka kthyer..., pra 2 herë. Nuk ka të drejtë. Vetëm kemi rregulluar parregullsitë e prefektit. Vetëm kemi rregulluar oraret. Kam dhe një relacion, do ta lexoj. Ky relacion del nga Sektori Juridik dhe firmoset nga prefekti . Lexon...Nëse sektori juridik nxjerr një relacion, duhet firmosur nga drejtori juridik dhe prefekti duhej të shprehej me vendim. Jemi përballë një gjendje tragjiko komike, ku shkresa që konceptohet dhe firmoset nga vetë ai .

Ligji..... këshilli bashkiak u shpreh me vendim, kështu që për prefektin ngelet vetëm vendimi i gjykatës .

Në bazë të nenit 16 të ligjit nr 107/2016 , ky nen parashikon verifikimin e pavlefshmërisë dhe jo të kthejë për së dyti një akt në këshill. (Bashkëlidhur relacioni ).

Znj.Migena Balla –Në rendin e ditës kemi 11 pika, 10 projekt vendime dhe miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 19 gusht dhe 1 shtator 2022. Jemi munduar të jemi korrekt sipas rregullores.

Z.Ardian Skëndaj - Nuk mund të flasë çdo njeri . Do flasim kur të kërkoet diçka.

Znj.Migena Balla - Pikërisht për këtë po flas. Këto 10 pika që kaluam në kryesinë e këshillit. Jeni dakort me rendin e ditës ?

Votohet.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota

Pro , të gjithë 31 vota.

Miratohet.

Z.Ardian Skëndaj - Të gjithë drejtorët duhet të jenë të pranishëm, e kanë detyrim, zonja nënkryetare.

Znj.Migena Balla – Të vazhdojmë. Po shoh që ka përfaqësues nga administrata, drejtorë dhe specialist.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në Miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së këshillit bashkiak datë 19.08.2022 dhe datë 01.09.2022.

Materialet i keni marrë, jeni njohur. Keni ndonjë gjë ?

-Jo.

Atëherë kalojmë në votim.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro, të gjithë 31 vota.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/2, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin gusht 2022”.

Një relacion nga administrata.

Znj.Irena Stasa – Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, janë sipas bashkisë dhe njësive,

-Bashkia Vlorë – 28 familje.

-Njësia Qendër – 3 familje.

-Njësia Orikum – 1 familje.

-Njësia Shushicë – 2 familje.

-Njësia Novoselë – 1 familje .

Janë gjithësej 35 familje përfituese me vlerën e fondit të përcaktuar.

-4 familje të reja kanë dalë nga skema dixhitale .

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo .

Kalojmë në votim.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro , të gjithë -32 vota.

Miratohet .

Z.Ardian Skëndaj – Në lidhje me familjet që janë jashtë tek ish-shtëpia e oficerëve, është bërë gjë? Keni informacion.

Znj.Irena Stasa – Po, jemi kujdesur për fëmijën....

Z.Ardian Skëndaj - Janë shumë problem. Flenë jashtë të rritur dhe fëmijë.

Znj.Migena Balla - Do ta lëmë ta diskutojmë tek pika “Të ndryshme “. S’ka lidhje me projekt vendimin.

Z.Ardian Skëndaj - Më vret gjendja e qytetarëve.

Znj.Migena Balla – Po shkelim rendin e ditës . Ta vendosim tek pika “Të ndryshme “. Nga zyra e strehimit, kemi ndonjë informacion.

Znj.Drita Mustafai - Lidhur me këto familje , hyjnë e dalin me vullnetin e tyre. U është dhënë mundësia për të aplikuar , për përfitimin e bonusit të qirasë. Është kontrata e qirasë që duhet lidhur nga qytetarët , për post dokumentacionin që plotësojmë ne .



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/3, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin gusht 2022”.

Një relacion nga administrata .

Znj.Irena Stasa - Granti vjen nga qeveria. Ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar përfitojnë 16 familje me fondin e akorduar.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro, të gjithë – 32 vota.

Miratohet.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/4, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për miratim, për aprovimin e shpenzimeve të të miturit Artemis Arsen Qamili, i ardhur nga familje me probleme të thella social ekonomike , i braktisur nga prindërit biologjik që do të mbështetet me ndihmë nga të ardhurat e bashkisë “.

Znj.Irena Stasa - Jeni njohur me materialin . Kemi folur me psikologun e shkollës, është fëmijë i braktisur nga i ati. Kemi menduar ta akomodojmë tek shkolla “Industriale “, tek konvikti për fjetje dhe vaktet ushqimorë si dhe, të arsimohet në atë shkollë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro – 32 vota.

Miratohet.





---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/5, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për miratimin e vlerës finsnciare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës të zotit Gëzim Toskaj, në datën 11.07.2022 dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Një relacion nga administrata.

Z.Adrian Vreshtazi – Drejtorja e Mbrojtjes Civile , vjen me 2 projekt vendime, për caktimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesave të zotit Gëzim Toskaj dhe zonjës Irena Murati. Është procedurë e njëjtë. Bazë është VKM Nr 329 , fillon me kërkesën e qytetarit dhe vazhdon me këshillin e qarkut....

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro – 32 vota.

Miratohet.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/6, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për miratimin e vlerës finsnciare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës të zonjës Irena Murati , në datën 18.07.2022 dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Relacioni u bë për të dy projekt vendimet . Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Votohet.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro – 32 vota.

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/7, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 7 të rendit të ditës, në “ Miratimi i raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar – gusht 2022”.

Nga administrata.

Z.Daut Zëraj - E kemi detyrim ligjor , të paraqesim disa nga treguesit për të ardhurat dhe shpenzimet për 8-mujorin, janar – gusht.

Përgjithësisht treguesit kanë ecur siaps planifikimit si dhe treguesit e shpenzimeve.

-Taksa e pasurisë , për familjarët, si ndriçimi, pastrimi, gjelbërimi..Nga analiza që kemi bërë me Ndërmarrjen e Ujësjetllësit si agjent tatimor, nuk i ka gjithë familjet të rregjistruara, kështu që, ka qenë problem kjo taksë, vjelja e saj.

-Taksa e tokës bujqësore . Për tokat e dhëna me qira , do të shohim dhe më vonë do të sjellim një projekt vendim për ta kaluar në këshill.

Tek shpenzimet, realizimi është 60%.

-69% granti. Në total, nuk janë realizuar në 100% , për shkak të ....

-67miljon – projekte me investime të huaja .

-Kemi patur probleme me shlyerjen e faturave të pastrimit, pasi situacionet nuk janë paraqitur siç duhet. 150 milion lekë, janë gjendje në bashki. Nuk janë shlyer.

Z.Ardian Skëndaj – Kam kërkuar kontratën e pastrimit dhe, nuk e keni sjellë se zoti Petro ishte me leje.

Z.Daut Zëraj - Ky është një objekt diskutimi tjetër, çështje tjetër, nuk lidhet me këtë. Unë po jap treguesit financiarë.

Z.Ardian Skëndaj - Na sill kontratën , ta gjykojmë. Zoti Petro, me ardhjen tuaj , do të vinte dhe kontrata. Pse s'ka ardhur kontrata? Ka diçka.

Z.Daut Zëraj – Kontrata është legale.

Z.Ardian Skëndaj – Është legale, pse se sillni ?

Z.Daut Zëraj – Kontrata është ligjore .

Z.Ardian Skëndaj - Dua ta shohim kontratën, e kemi kërkuar dhe situacionet për 3 vitet e fundit.

Z.Daut Zëraj - Në buxhetin e Bashkisë Vlorë, janë 40 miljon shpenzime operative...me fillimin e Landfilldit. Jemi në procedurë prokurimesh ...Pak a shumë këto janë.

Z.Ardian Skëndaj - Sa janë realizuar të ardhurat si 8-mujor ?

Z.Daut Zëraj – 62% dhe shifrat në faqet 13 dhe 14.

Z.Grigor Dede – Mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për 8-mujorin, në mbledhjen e komisionit të financës nuk kemi patur shumicën e drejtorëve. Për çdo drejtori është pjesa e buxhetit. Të dijme se çfarë bëhet në çdo drejtori. Të raportohet nga drejtorët në mbledhjen e komisionit , si përdoren këto fonde . Situata me ujësjellësin, si agjent tatimor , shumë problematike.

Ka fatura të palikujduara, ka borxhe.

-1,4 miliard lekë që u mungojnë qytetarëve ...Si fillim duhet sqaruar problematika. Ndërmarrja është në gjendje kritike , qytetarët s’ marrin shërbimin e duhur.

Z.Kasëm Mahmuti – Pa përsëritur gjërat që u prekën, dhe ne në komisionin e strehimit e trajtuam i propozuam drejtorit përkatës , duke qenë problematikë e përsëritur në lidhje me ujësjellësin si agjent tatimor, administrata duhet të gjejë një zgjidhje alternative.

Mënyra e menaxhimit të kësaj ndërmarrje do ndryshojë , prandaj, administrata duhet të gjejë mundësi për vjeljen e taksës së ndërtesë dhe ndriçimit, pastrimit...

DAV ka përmirësime. Përveç këtyre dy zërave , po tërheq vëmendjen për vjeljen e taksës së tokës bujqësore dhe vaditja.

Për mua do ndryshuar metodika. Zero lekë për ujitje. Uji është përdorur, po arkëtimi pse është zero. Në lidhje me shpenzimet. Ka vonesa në prokurime për shkak të rritjes së çmimit, ka procedura të realizuara, ka në proces.

Ka diferenca në shpenzime; 89 miljon lekë për shkollat.

-Tërheq vëmendjen për paraqitjen e materialit nga ana e drejtorëve të bashkisë. Do të doja që raportimet të vijnë më serioze, këshilltarët i kanë materialet.

Znj.Liljana Breshani – Sot do ta kundërshtoj këtë raport, për mungesën dhe injorimin që bën kryetari i bashkisë.

Z.Ardian Skëndaj - 463 miljon .... Dua të di , janë plotësuar investimet, prokurimet...Kur, buxheti thua rritet 62% , ku do ti gjeni lekët, pa mbaruar investimet dhe kërkonit prioritete të tjera .

Z.Daut Zëraj – Tek buxheti i vitit 2022 është planifikuar një fond për rikonstruksion shkollash - 25 miljon, ku 5 miljon të procedohet veç dhe 20 miljon , nuk po kërkohet shtesë. Ne po kërkojmë këtë 20 miljonsh ta kalojmë dhe në 3 shkolla, është bashkëfinancim. Shpenzimet ecin paralelisht me të ardhurat. Sipas bilancit, ky fond është , 25 miljon. Nuk po kërkojmë shtesë.

Z.Ardian Skëndaj – Më jep aplikimet që keni bërë për arsimin. Sa aplikime janë bërë në Ministrinë e Arsimit, jo me kërkesë dore.

Z.Daut Zëraj - Duhet të ndajmë çështjen. Është në buxhet, apo jo .Ne nuk kemi kërkuar shtesë në buxhet, ai është i planifikuar.

Z.Ardian Skëndaj – Do hidhni 50 milion në shkollë fshati , ku s’ka nxënës shkolla, po mbyllet. Po me ujësjellësin, ishte 1% dhe e bëme 3% subvencionin . Ku janë lekët. Është gjendja shumë e keqe në Bashkinë Vlorë. Faktet janë fakte.

Z.Daut Zëraj – Fakti është që Bashkia Vlorë, po ecën financiarisht .Investimet në shkolla janë kërkuar që më parë . Çfarë të shqetëson zoti këshilltar, të mos ta kalosh fondin dhe për 2 shkollat e tjera.

Znj.Migena Balla – Po dalim nga rendi i ditës. Për çdo gjë që keni e diskutojmë tek pika “ Të ndryshme.”

Z.Daut Zëraj – Aplikime ka, por nuk e dija që do kërkoreshin sot.

Znj.Migena Balla - Është kërkesë e këshilltarit, e vini në dispozicion.

Z.Kasëm Mahmuti – I kërkoja një detaj për punën e pastrimit zotit Daut, duhet të relatojë. Dua një relacion të detajuar , nuk po ndajmë punën, ku fillon puna e “Dukës” dhe e bashkisë. Dua të di fondin për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike për pastrimin. Na e nisni me shkrim.

Z.Daut Zëraj - Është përfunduar procedura , blerje 3 kamionçina; është autoshakalla , shërbimi roje , shpenzimet operative (mjetet, karburant etj )

Znj.Migena Balla – Keni gjë tjetër ? Pyetje, diskutime ?

Z.Daut Zëraj – Unë po flas për treguesit financiarë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Hedhim në votim raportin e monitorimit të buxhetit .

Kundër – 1 votë.

Abstenim – 0 vota.

Pro – 31 vota.

Miratohet.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/8, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “ Mbi një ndryshim në VKB Nr 61 datë 27.10.2016 “ Mbi miratimin e rrjetit të linjave rrethqytetase dhe numrit të orareve për çdo linjë”.

Kemi dhe relacion nga administratorët e njësisë.

Z.Kanan Shakaj – Është kërkesë nga vetë qytetarët , dalë kjo dhe nga dëgjesat publike që u bë në njësinë tonë .

Z.Kasëm Mahmuti - Kam pas dje një reagim, në mbledhjen e komisionit. Nuk ishin të qarta kapaciteti dhe dokumentacioni i mjeteve. Erdhën sot. Por do të propozoja që ky orar të bëhet çdo 1 orë dhe jo çdo gjysëm ore.

Znj.Migena Balla – E hedhim në votim me propozimin e zotit Kasëm , pra jo çdo gjysëm ore, por çdo 1 orë.

Votohet.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro – 32 vota.

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/9, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 9 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “ Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet në nevojë që nuk mund të përballojnë qiratë e tregut të lirë, sipas strukturave takuese të apartamenteve të tyre”.

Një relacion nga administrata .

Znj.Drita Mustafai - Ky projekt vendim është sjell për miratim nga kërkesat bazuar në ligjin, “Për strehimin social “. Ky projekt vendim mbështetet dhe në kërkesat e qytetarëve që nuk përballojnë çmimin e qirasë , kërkojnë subvencion nga bashkia.

Nga ana jonë dhe komisioni i strehimit , është bërë një punë shumë e madhe në terren.

Është përjashtuar zona e Ujit të Ftohtë nga këto çmime..., për afatin , jo më pak se 1 vit dhe, jo banesa të pabanuara.

Referuar të dhënave të INSTAT-it , sipas rritjes së çmimeve, janë në kushte jo të mira ekonomike .

Për përcaktimin e vlerës mesatare të qirave në terren, grupet e punës kanë dalë në terren, dhe më pas komisioni i strehimit për vendimmarrjen.

Vlerat sipas trukturave janë në material.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

E hedhim në votë.

Votohet.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro – 32 vota.

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal

Nr 12/10, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 10 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për një shtesë në VKB Nr 80 datë 02.12.2021 “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për ato, në territorin e Bashkisë Vlorë”.

Znj.Sonela Haxhiraj - Ky projekt vendim ka për qëllim shtimin e dy pikave , “s dhe t”, në lidhje me sanksionet për bizneset , taksitë pirate etj,..., ushtrim aktiviteti i paligjshëm, masa 20mijë lekë. Por, me kërkesë të këshilltarit të vendoset masa nga 10 ÷ 20 mijë lekë.

Tek pika 2, (lexon...) të shtohet pika” t “.

Ky material vjen nga policia bashkiake për ushtrimin dhe funksionimin e punës së policisë.

Z.Ardian Skëndaj – Policia bashkiake, nuk kthen përgjigje, s’bën punën. Janë 27 subjekte ....

Znj.Anjeza Shiko - Akt marrëveshja është bërë nga bizneset. Vendimi i këshillit bashkiak lejon kur s’ka marrëveshje me bashkinë, i paguan tarifatat nga kontrollat në terren. Këta kanë akt marrëveshje , këto bëhen me akte kontrolli. Policia bashkiake është vënë në dijeni deri në datën 20 gusht.

Z.Ardian Skëndaj - Sipërfaqen bizneset e marrin dhe ankohen për tarifën. Ata s’pagojnë, shumë problem në lungomare, nxjerrë tavolinat në rrugë. Puna e kujt është kjo .

Znj.Anjeza Shiko - Për lirim të hapsirave publike , nuk është pjesë e komisionit ....

Z.Ardian Skëndaj – Ata s’bëjnë punën, duan të rrisin gjobën.

Z.Kreshnik Tepelena – Një sygjërim, në lidhje me stacionet e plazhit. Në fillim të sezonit , të ngrihet një task forcë bashkë me ministrinë, por kontrollat herë pas here nga institucione të ndryshme, është e lodhshme për biznesin.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

Atëherë e hedhim në votim.

Për pikën 1 , këshilltari ka dhënë propozim, alternativë, është 10÷20 mijë lekë.

Po, e hedhim në votim me këtë ndryshim dhe jo liçensimi po mosliçensimi.....



Z.Simo Petromilo - Lidhur me këtë projekt vendim, nuk jam dakort. Në datën 2 dhjetor , ne kemi miratuar sanksionet për shkelje të ndryshme. Në harkun kohor prej 10 muajsh kjo punë është bërë vetëm klienteliste.(Lexon , kujt drejtorie i ngarkohet për zbatim ky VKB)  
Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr 80 që u nda veç nga buxheti, kjo është punë e mirë dhe do përgëzuar. Por , për çdo kundravajtje , është bërë klienteliste. Prandaj, vota ime shkon kundër këtij projekt vendimi .

Z.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votë. Votohet.

Kundër - 1 votë(Z.Simo Petromilo )

Abstenim – 1 votë.

Pro – 30 vota.

Miratohet .



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/11, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 11 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për transferimin kapital të mjeteve për grumbullimin e mbetjeve dhe pastrimin e rrugëve nga Bashkia Vlorë te Bashkia Selenicë “.

Një relacion nga administrata.

Znj.Arjona Puka - Në zbatim të marrëveshjes me Qeverinë Gjermane, neni 4,1....Mjetet kanë ardhur në Bashkinë Vlorë, thjesht do transferohen në Bashkinë Selenicë. Janë për Bashkinë Selenicë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro – 32 vota.

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

Procesverbal  
Nr 12/12, datë 30.09.2022

Znj.Migena Balla – Në lidhje me pikën “Të ndryshme”, fjalën e ka zonja Jonela, si Kryetare e Aleancës së Grave Këshilltare.

Znj.Jonela Halili – Referon , në lidhje me përfaqësimin e kësaj aleance, qëllimin, mbështetjen dhe iniciativat e ndërmarra nga kjo aleancë.

(Bashkëlidhur referimi i zonjës Jonela Halili )

Znj. Migena Balla - Vazhdojmë me pikën “Të ndryshme “.

Z.Sokol Kushta – Zoti Kasëm ngriti diçka që na intereson, pra pastrimin. Kam kërkuar informacion për pastrimin dhe nga bashkia dhe nga firma e pastrimit. Kam kërkuar shumë herë një diskutim, nuk ka ardhur dhe nuk e pres që të vijë. Mos marrja e përgjegjësisë është arrogancë.

Kam një informacion për një shkelje nga bashkia. Familja Jonuzaj , ka një sipërfaqe tek stacioni i autobuzave. Bashkia e di që ata kanë certifikatë pronësie. Dua të di pse e ka zaptuar bashkia.

Dua një informacion, një përgjigje si fillim.

Znj.Sonela Haxhiraj – Për familjen Jonuzaj, ata janë në gjyq me Gjykatën e Apelit. Nuk ka përfunduar. Ka pas probleme me pronësinë , ka mbivendosje me subjektet dhe janë në gjyq..Proçedimi penal nuk është me Bashkinë Vlorë.

Z.Sokol Kushta- A është certifikatë kjo ?

Znj.Sonela Haxhiraj – Po, por me të njëjtin numër pasurie janë 2 subjekte. Statusi ka qenë shtet. Tani është bërë rregjistrimi.

Z.Daut Zëraj – Për çështjet që hyn gjykata... për tek ish parku i autobuzëve , po flas për statusin juridik. Janë në gjyq me AKKP.

Z.Sokol Kushta - Pse nuk ia jepni, e keni zaptuar.

Z.Daut Zëraj – Janë dy subjekte me të njëjtën pronë.

Z.Grigor Dede – Kam bërë kërkesë në datën 1 korrik . Kam kërkuar material në lidhje me pastrimin që ka bërë bashkia dhe firma .

-Sa përqind e plazheve ka qenë privat dhe , sa publik.

Do të vijë përsëri sezoni turistik dhe qytetarët , nuk do të gjejnë dot plazh publik.

-Për zbatimin e kontratës së pastrimit me bashkinë dhe firmën “Duka “.

-Shfrytëzimi i plazheve , sa përqind publik dhe sa përqind privat.

Znj.Sonela Haxhiraj – Për plazhet do ta vëmë në dispozicion relacionin me shkrim. Por grupi i punës ka patur vështirësi në lidhje me ASIG dhe, me numër parcelash .

Znj.Liljana Breshani – Në datën 1 shtator , kam kërkuar një relacion në lidhje me kafshët e rrugës. Pra, nuk është bërë asgjë konkrete. Faleminderit përgjigje ka ardhur. Unë e inkurajoj bashkinë për të ngritur një strukturë, në bashkëpunim me strukturat e ngritura.

-Dua një statistikë dhe planin , një projekt ide.

Znj.Rozina Kormuzi – Gjatë mbledhjes, kryetari i grupit ngriti problemin e banorëve tek ish-shtëpia e oficerëve. Ata s’plotësojnë asnjë kusht. Dihet gjendja e tyre dhe jo më të bëjnë kontratë qiraje.

Sygjerim ose kërkesë që, bashkia të japë zgjidhje për këto familje për periudhën e dimrit.

Znj.Migena Balla – Bashkia nuk di ku do ti mbështesë..

Z.Ardian Skëndaj – Këta të akomodohen në struktura të pabanuara. Këtu në bashki ke hidraulikë, bojaxhinj.... Jo më kot kam kërkuar dhe organigramën. Të gjendet një strukturë e braktisur dhe të bëhet. Zonja nënkryetare na gjej përsëri përgjegjës për këtë.

Znj.Aulona Veizi – Nuk mund të zgjidhet tani . Do diskutoj me drejtorët dhe kryetarin e bashkisë. Jemi këtu për një qëllim, mos të krijojmë hendek.

Z.Ardian Skëndaj - Pse nuk na kthen përgjigje?

Znj.Aulona Veizi - Administrata punon, të bashkëpunojmë. Kemi problemet tona, por kemi qytetarin në themel të punës tonë. Nuk është future këtë radhë projekt vendimi për rikonstrukcionin e kopshteve dhe shkollave. Në rast se ju nuk e fusni as në axhendë, jo ta aprovoni. Janë bashkëfinancime me BE. Jemi të gjithë për Vlorën.

Z.Ardian Skëndaj – Erdhët për një bashkëfinancim për kopshtin. Diskutoam. Ju thamë të sillnit letrat, nuk i sollët. Ishte 2 milion fondi, sot është bërë 2,8 milion.

Znj.Aulona Veizi – Mos e anullo. Ne dje i kemi patur të gjitha gati për këtë mbledhje.

Z.Ardian Skëndaj – Do vendosin këshilltarët ku do hidhen këto fonde.

Kemi kërkuar argumentim me shkrim. Do përgjigjeni zyrtarisht.

Znj.Migena Balla – Nuk mund të pres fjalën.

Z.Selim Haskoçelaj – Do na dëgjoni dhe ju zoti këshilltar.

Znj.Migena Balla – Këshilltarët nuk tërhiqen nga kërkesat e tyre. Por, do ta dëgjojmë , është administrator.

Z.Selim Haskoçelaj – Duhet ta dëgjosh popullin. Bashkia është shumë e organizuar.

Znj.Migena Balla – Është e drejta e këshilltarëve të bëjnë kërkesa dhe ktheni përgjigje. Çështja e artikullimit dhe përgjegjësit, janë personale.

Znj.Jonela Halili – Po kërkohet përgjigje.

Znj.Liljana Breshani - Jemi në radhë të parë qytetarë. Është mungesë respekti.

Z.Teki Xhemalaj - Duhet të gjejmë mekanizmin që , administrata dhe këshilli , të punojnë . Kanë këshilltarët kaq kohë që kërkojnë dhe nuk marrin përgjigje. Të ulemi të gjithë, të gjejmë frymën e bashkëpunimit.

Znj.Jonela Halili – Administrata të bëjë punën .Ktheni përgjigjet e kërkesave të këshilltarëve.

Znj.Migena Balla – Siç ju jap fjalën juve, do t’ia jap dhe administratorit. Pse i kërkojmë të jenë të pranishëm, kur nuk i lëmë të flasin ?

Unë ju jap të drejtën e fjalës, kjo nuk është normale.

Z.Ardian Skëndaj – Le të japin përgjigje me shkrim.

Znj.Migena Balla – Zonja Erinolda, ka kërkuar fjalën, duhet tia japim , është përfaqësuese e administratës. Ato që duhen me shkrim.

Znj.Erinolda Lushaj – Për shkak të problematikës së hidrovorit, për arsye kohe, erdhi me vonesë kërkesa.

Znj.Migena Balla – Bëni gati materialin, relacionin. Është urgjente . Jemi përballë shirave. Kërkoni një mbledhje jashtë radhe dhe vendosim.

Z.Ardian Skëndaj – Na sqaroni kur është blerë kjo pompë, garancinë ...etj, të sqaruara .

Znj.Migena Balla – Tjetër ?

Z.Ardian Skëndaj - Kam disa kërkesa . (Lexon )

-Kontratat e firmës së pastrimit që operojnë në qytet dhe njësi, si dhe situacionin për 3 vitet e fundit.

-Organigrama e bashkisë dhe institucioneve vartëse .

-Numri i punonjësve që janë në moshë pensioni ....(Bashkëlidhur kërkesat).

Znj.Migena Balla – Pra, tek ju , këtë do të sillja në vëmendjen . Për çdo kërkesë që silllet nga këshilltarët , të kthehet përgjigje.

Z.Ardian Skëndaj – Për investimet, për fondin 20 milion lekë, ato lekë nuk do ti lëmë të digjen. Dakort, të vijë materiali.

Znj.Aulona Veizi - Është bërë një projekt për shkollën “15 Tetori “.

Z.Ardian Skëndaj – Sa është numri i fëmijëve në Kopshtin Nr 8 dhe sa është vlera e qirasë.

Znj.Fjona Rrokaj – Numri nuk është mbyllur. Jemi në proces rregjistrimi. Nesër mbyllet faza e pare. 80÷90 fëmijë , pak a shumë deri tani.

Znj.Migena Balla – Në atë territor , nuk ka pasur kopësht, prandaj u gjet ajo mundësi. S’di sa është qiraja.

Nëqoftëse s’ka gjë tjetër, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit.

Mbajti Procesverbalin

Zhaneta Gjika